



©Copyright KOMF



MË ÇO NË SHTËPI!

ANALIZË E SHKURTËR MBI AVANCIMIN E MBROJTJES
SË FËMIJËVE TË BRAKTISUR NË KOSOVË (0 - 3 VJEÇ)

Prill 2014

Ky publikim nuk reflekton domosdoshmërisht
qëndrimet e donatorëve të KOMF.

Ky publikim nuk mund të shitet ose të përdorët
për qëllime përfitimi.

Foto: @copyright at KOMF

*Rruga: Zenel Salihu
OB.1, HY.1, K.3, Nr.16,
10000 Prishtinë, Kosovë*

*info@komfkosova.org
www.komfkosova.org
Facebook: KOMF
Twitter: @komfkosova*

MË ÇO NË SHTËPI!

ANALIZË E SHKURTËR MBI AVANCIMIN
E MBROJTJES SË FËMIJËVE TË BRAKTISUR NË KOSOVË
(0-3 VJEÇ)

KOALICIONI I OJQ-ve PËR MBROJTJEN E FËMIJËVE
PRILL 2014, PRISHTINË

Përmbajtja

Falenderime.....	5
Shkurtesat	6
Përmbledhje ekzekutive	7
Metodologjia e punës.....	8
Literatura e shfrytëzuar për hartimin e kësaj analize	8
Mbulimi gjeografik	8
Realizimi i pyetësorëve.....	8
KAPITULLI 1 - Përmbledhje e legjislacionit për fëmijët e braktisur në Kosovë	9
1.1 Legjislacioni.....	10
KAPITULLI 2 - Analizë e sistemit për fëmijët e braktisur	13
2.1 Të gjeturat e përgjithshme.....	14
2.1.1 Të gjeturat nga QKUK në Prishtinë	15
2.1.2 Të gjeturat nga SOS Fshatrat e Fëmijëve	17
2.1.3 Të gjeturat nga familjet strehuese	18
2.1.4 Të gjeturat nga Qendrat për Punë Sociale - QPS	19
2.1.5 Të gjeturat nga Paneli	22
2.1.6 Të gjeturat nga Gjykatat Themelore.....	24
KAPITULLI 3 - Këndvështrimi i përgjithshëm psiko-fizik dhe social	25
3.1 Këndvështrimi i përgjithshëm i zhvillimit të fëmijëve të braktisur 0-3 vjeç	26
3.2 Efektet psikoshëndetësore	27
KAPITULLI 4 - Rekomandimet.....	29
4.1 Rekomandime afatshkurtra	30
4.1 Rekomandime afatmesme.....	32

Autorë

Gladiola Strugaj - KOMF

Donjeta Kelmendi - KOMF

Gani Lluga - ASTRA

Mjellma Luma - SOS Fshatrat e Fëmijëve

Blerta Canaj Meta - Amici Dei Bambini

Arben Gashi - Terre des Homes

Falenderime

Në emër të misionit të përbashkët për mbrojtjen, respektimin dhe avancimin e të drejtave të fëmijëve në Kosovë, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve - KOMF, falenderon të gjithë ata që kontribuan në hartimin e kësaj analize, që ka qëllimin të kontribuojë në avancimin e mbrojtjes së fëmijëve të braktisur në Kosovë.

Falenderim të veçantë KOMF shpreh për të gjithë ata që u përfshinë në këtë analizë:

- Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjes;
- Qendrën për Punë Sociale në: Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë, Ferizaj dhe Fushë-Kosovë;
- Gjykatat Themelore në: Prishtinë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë dhe Ferizaj;
- Qendrën Klinike Universitare në Kosovë - QKUK;
- Familjet strehuese;
- Organizatat jo-qeveritare;
- Agjencionet ndërkombëtare.

Falenderojmë Organizatën SOS Fshatrat e Fëmijëve dhe fondacionin Terre des hommes për përkrahjen financiare për realizimin e kësaj analize.

Një falenderim i veçantë shkon po ashtu për grupin punues të KOMF: Gladiola Strugaj – Zyrtare e projektit në KOMF, Mjellma Luma – Zyrtare për Avokim në SOS Fshatrat e Fëmijëve, Gani Lluga – Drejtor Ekzekutiv në ASTRA, Blerta Canaj Meta – Koordinatore në Amici dei Bambini, Donjetë Kelmendi – Drejtoreshë Ekzekutive në KOMF dhe Arben Gashi – Koordinator për Avokim në Terre des hommes.

Me respekt,
Blerta Perolli – Shehu
Presidente

Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve

A handwritten signature in blue ink, which appears to be 'Blerta Perolli', is written over the printed name and title.

Shkurtesat

DKSHMS	Drejtorati Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
DPSF	Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes
KDF	Konventa për të Drejtat e Fëmijëve
KOMF	Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve
LFPL	Ligji për Financat e Pushtetit Lokal
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
OJQ	Organizata jo-qeveritare
QPS	Qendra për Punë Sociale
QKUK	Qendra Klinike Universitare e Kosovës
QVSHM	Qendra për Vendosje Afatshkurtër dhe Afatmesme të Fëmijëve Nevojtarë në SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
SOS	SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët

Përmbledhje ekzekutive

Analiza për avancimin e mbrojtjes së fëmijëve të braktisur në Kosovë të moshës 0-3 vjeç, vjen si rezultat i nevojës për identifikimin e ngecjeve në sistem dhe sfidave të institucioneve të mandatuara për kujdesin e fëmijëve të braktisur, identifikimin e faktit se sa po i përgjigjen institucionet nevojave të fëmijëve dhe sa respektohet interesi më i lartë i fëmijëve të braktisur. Problematika sikurse qëndrimi i gjatë i fëmijëve të braktisur në ambientet spitalore dhe në format alternative të strehimit, tash e sa vite vazhdon të mbetet shqetësuese pa një arsye të faktuar zyrtare dhe në kundërshtim me interesin më të mirë të fëmijës.

Kjo analizë është përqendruar tek vlerësimi i tri shtyllave bazë për ofrimin e mbrojtjes së fëmijëve të braktisur (me fokus në formën e mbrojtjes së adoptimit), sikurse: legjislacioni, funksionimi i sistemit dhe një këndvështrim i përgjithshëm i zhvillimit të fëmijëve të braktisur 0 – 3 vjeç gjatë qëndrimit të tyre në format alternative të strehimit.

Gjatë procesit të hartimit janë marrë në konsideratë pikëpamjet e institucioneve të mandatuara për ofrimin e mbrojtjes për fëmijët e braktisur siç janë: Qendra Klinike Universitare e Kosovës, 6 qendra për Punë Sociale, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes, 5 Gjykata Themelore, familjet strehuese për fëmijët pa përkujdes prindëror, kujdesi familjar i bazuar në komunitet, agjencitë ndërkombëtare dhe OJQ-të.

Bazuar në të gjeturat e kësaj analize, del se ka mungesë të theksuar të punës në parandalim të braktisjes, moskoordinim të bashkëpunimit ndërinstitucional, paqartësi rreth legjislacionit dhe procedurave, neglizhencë të afateve kohore dhe ligjore, mbingarkesë dhe numër i madh i lëndëve/rasteve, mungesë të trajnimeve multidiciplinare, shpesh-herë shterje profesionale, lëndë të pakompletuara me dokumentacionin e nevojshëm si dhe numër i vogël i familjeve strehuese.

Problematika kryesore lidhur me fëmijët e braktisur qëndron në vonesat për procedurat e zgjidhjes së statusit të tyre dhe në cilësinë e shërbimeve të ofruara. Këto dhe shumë fakte të tjera që paraqiten në këtë analizë tregojnë arsyen e qëndrimit të gjatë dhe të panevojshëm të fëmijëve në strehim rezidencial, komunitar apo dhe familjar.

Kosova fatmirësisht është një ndër vendet e rralla në Evropën jug-lindore që nuk ka jetimore për fëmijë dhe ka të përfshira format alternative të mbrojtjes në kuadër të legjislacionit në fuqi, por që përsëri kjo analizë tregon një situatë që jo gjithmonë është e favorshme lidhur me zgjidhjen e statusit të fëmijës dhe ofrimin e formave alternative të mbrojtjes që përmbushin interesin më të mirë të fëmijës.

Në nevojën reale për të u kanalizuar tek interesi më i mirë i fëmijëve të braktisur dhe tek mos qëndrimi i tyre i gjatë me status të pazgjidhur, kjo analizë është përqendruar vetëm në pikat kyçe ku sistemi ka ngecje. Duke mos mohuar për asnjë moment punën e cila bëhet nga institucionet publike dhe OJQ-të, problematikat e identifikuara nga kjo analizë janë pasqyruar më poshtë, janë analizuar nga grupi punues dhe janë shoqëruar me rekomandime konkrete si për kontekstin e Kosovës ashtu dhe në përputhshmëri me interesin më të mirë të fëmijës, me qëllimin për të përmirësuar praktikën dhe për të avancuar shërbimet në favor të mbrojtjes së fëmijëve të braktisur.

Metodologjia e punës

Objektivi kryesor është ofrimi i një analize të:

- I. **Legjislacionit:** përmbledhje e legjislacionit për mbrojtjen e fëmijëve të braktisur dhe pa përkujdes prindëror, me fokus në format alternative të mbrojtjes;
- II. **Funksionimit të sistemit:** reagimi i sistemit në rastet e braktisjes së fëmijëve, zbatimi i legjislacionit, procedurat përkatëse, puna ndërinstitucionale dhe pengesat në sistem me fokus gjatë realizimit të formës së mbrojtjes adoptimit;
- III. **Gjendjes shëndetësore dhe psikosociale:** këndvështrim i përgjithshëm i gjendjes shëndetësore dhe psikosociale të fëmijëve të braktisur në Kosovë, plotësimi i standardeve për mirëqenien dhe zhvillimin e tyre.

Literatura e shfrytëzuar për hartimin e kësaj analize:

- Kushtetuta e Republikës së Kosovës;
- Ligji për Familje i Kosovës Nr. 2004/32;
- Ligji mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-32;
- Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare i ndryshuar Nr. 2011/04-L-081;
- Konventa e të Drejtave të Fëmijëve – KDF;
- Standardet minimale për shërbimet sociale;
- Raportet e ndryshme institucionale nga agjencitë e ndryshme lidhur me strehimin familjar apo atë rezidencial për fëmijët¹.

Mbulimi gjeografik:

Intervistat dhe pyetësorët janë realizuar me përfaqësues të institucioneve të mandatuara për mbrojtjen e fëmijëve të braktisur në 6 komuna: Gjakovë, Prizren, Ferizaj, Mitrovicë, Prishtinë dhe Fushë Kosovë.

Realizimi i pyetësorëve:

- Mjekët e Spitalit në Klinikën e Gjinekologjisë në QKUK;
- Punëtori social në QKUK;
- Infermierët në Klinikën e gjinekologjisë në QKUK;
- Udhëheqësit e shërbimeve sociale dhe familjare në Qendrat për Punë Sociale;
- Zyrtarët në Departamentin e Politikave Sociale dhe Familjare;
- Familjet strehuese;
- Gjyqtarë në gjykatat themelore;
- OJQ-të;
- Agjencionet ndërkombëtare.

¹ <http://www.osce.org/sq/kosovo/71206?download=true>
Agjencia e Statistikave Kosovë – ASK

R. L. Altman, J. Canter, P. A. Patrick, N. Daley, N. K. Butt dhe D. A. Brand (2011). Parent Education by Maternity Nurses and Prevention of Abusive Head Trauma. *PEDIATRICS*, 128 (5), e1164-e1172. Doi: 10.1542/peds.2010-3260, <http://pediatrics.aappublications.org/content/128/5/e1164.full.html>

Kapitulli 1

Përmbledhje e legjislacionit për
fëmijët e braktisur në Kosovë

1.1 Legjislacioni

Mbrojtja e fëmijëve të braktisur dhe sigurimi i mirëqenies në kuadër të një familje garantohej me Konventën ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe legjislacionin në fuqi. Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF) garanton se kur një fëmije i mohohet përkohësisht ose në mënyrë të përhershme mjedisi familjar, ose kur nuk është në interesin e tij/saj më të lartë të qëndrojë në këtë mjedis, ai/ajo ka të drejtë për një mbrojtje dhe një ndihmë të posaçme nga shteti. Shtetet palë sigurojnë për fëmijën një përkujdesje alternative, në përputhje me legjislacionin e tyre të brendshëm². KDF parasheh se “interesi më i mirë i fëmijës do të jetë konsiderata parësore” në procedurat e adoptimit dhe se adoptimi i fëmijës do të jetë “i autorizuar vetëm nga autoritetet kompetente” të cilët do t’i marrin vendimet “në përputhje me ligjin dhe procedurat e aplikueshme”.

Kosova për shkak të statusit të saj politik, nuk ka ratifikuar KDF-në, megjithatë, legjislacioni i brendshëm bazohet në instrumentet ndërkombëtare për mbrojtjen e fëmijëve të braktisur. Në Republikën e Kosovës legjislacioni në fuqi rregullon mbrojtjen e fëmijëve të braktisur dhe format alternative të mbrojtjes kryesisht përmes Ligjit për Familjen i Kosovës Nr. 2004/32, Ligjit për Shërbimet Sociale dhe Familjare Nr. 02/L-32 dhe Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare i ndryshuar Nr. 2011/04-L-081. Ligji për Familjen i Kosovës është ligj bazik, i cili rregullon mbrojtjen e fëmijëve pa kujdes prindëror si dhe format e mbrojtjes. Për nevojat e kësaj analize, në vijim janë paraqitur çështjet kryesore të ligjit në fjalë lidhur me format alternative të mbrojtjes, me fokus tek adoptimi i fëmijëve të braktisur dhe çështjeve të ndërlidhura.

Ligji mbi Familjen përcakton Organin e Kujdestarisë që të ushtrojë mbikëqyrjen e përgjithshme dhe të vazhdueshme ndaj ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindërore³. Dispozitat ligjore në kuadër të këtij ligji fillojnë që nga koha kur fëmija ka lindur dhe prindërit e të cilit janë të panjohur, e deri tek përfundimi i procedurës për aplikimin e ndonjëres prej formave të veçanta të mbrojtjes për fëmijët pa përkujdes prindëror, përfshirë adoptimin. Format themelore të mbrojtjes juridike dhe familjare të fëmijëve pa kujdesin prindëror në kuptim të këtij ligji janë: kujdestaria, strehimi familjar, strehimi rezidencial dhe adoptimi⁴. Theks të veçantë Ligji mbi Familjen i jep rregullimit të adoptimit, kujdestarisë dhe vendosjes së organizuar në familje, si forma të veçanta për mbrojtjen e fëmijëve pa përkujdes prindëror.

Ligji mbi Familjen përcakton që fëmijë pa kujdes prindëror konsiderohet fëmija prindërit e të cilit nuk janë gjallë, prindërit e të cilit janë të panjohur ose janë zhdukur; fëmija prindërit e të cilit për çfarëdo arsye, në mënyrë të përkohshme ose të përhershme nuk i kryejnë detyrat e tyre prindërore ose kujdesin prindëror⁵. Sa i përket adoptimit si formë e mbrojtjes, autoriteti kompetent për adoptim është Gjykata, mirëpo Gjykata mund të kërkojë këshilla nga Organi i Kujdestarisë gjatë marrjes së vendimit mbi adoptim⁶.

Ligji mbi Familjen kur është fjala tek procedurat e adoptimit, kryesisht parasheh dispozita ligjore përsa i përket rolit të Gjykatës dhe procedurave të gjyqësorit në lidhje me adoptimin, Organi i Kujdestarisë në bazë të dispozitave aktuale, përcaktohet si një Organ Këshillëdhënës për Gjykatën kur është fjala tek adoptimi, përderisa ky ligj përcakton Organin e Kujdestarisë që të ushtrojë mbikëqyrjen e përgjithshme dhe të vazhdueshme ndaj ushtrimit të të drejtave dhe detyrave prindërore për fëmijët pa përkujdes prindëror⁷.

² Neni 20, KDF

³ Neni 146, Mbikëqyrja nga Organi i Kujdestarisë, Ligji mbi Familjen i Kosovës

⁴ Neni 157, Parimet e ruajtjes së fëmijës, paragrafi 2, Ligji mbi Familjen i Kosovës

⁵ Neni 156, Fëmijët pa kujdes prindëror, Ligji mbi Familjen i Kosovës

⁶ Neni 161, Autoriteti kompetent për adoptim, Ligji mbi Familjen i Kosovës

⁷ Neni 146, Mbikëqyrja nga Organi i Kujdestarisë, Ligji mbi Familjen i Kosovës

Gjykata ka të drejtë të mbledhë të dhëna dhe dëshmi të tjera nga Organi i Kujdestarisë, nga shërbimet shoqërore dhe nga ekspertë të tjerë në lëmin e përkujdesjes së fëmijës mbi kushtet e adoptimit⁸. Fëmija i përcaktuar pa përkujdesje prindërore nga organi kompetent mund të adoptohet nga persona të cilët kërkojnë të adoptojnë dhe të cilët janë regjistruar tek organi përkatës i cili është i autorizuar për të iniciuar procedurën, e që në këtë rast është Qendra për Punë Sociale. Sa i përket afateve kohore dispozitat ligjore përcaktojnë që për adoptimin e fëmijës kërkohet pëlqimi i prindërve biologjik dhe se pëlqimi nuk mund të jepet para se t'i ketë mbushur fëmija tetë javë. Pëlqimi duhet t'i deklarohet Gjykatës dhe bëhet i plotfuqishëm në kohën e dorëzimit. Nuk kërkohet pëlqim nga bashkëshorti, i cili me vendim të Gjykatës e ka humbur kujdestarinë ose e ka humbur aftësinë për të vepruar, ose vendbanimi i të cilit nuk dihet për më shumë se një vit⁹. Pëlqimi i prindit bëhet i joplotfuqishëm nëse fëmija nuk adoptohet brenda tri viteve nga data kur pëlqimi bëhet efektiv¹⁰. Nëse Gjykata konstaton se janë plotësuar kushtet për adoptim do të themelojë adoptimin¹¹.

Ligji mbi Familjen rregullon edhe vendosjen e organizuar në familje, ku fëmijëve pa prindër dhe fëmijëve pa kujdesin prindëror u garantohet vendosja në familje deri sa të aftësohen për jetë dhe punë të pavarur. Pas vendosjes së fëmijës në familjen tjetër, Organi i Kujdestarisë ndërmer menjëherë të gjitha masat e domosdoshme që të adresojë dhe në të ardhmen të mënjanojë të gjitha rrethanat të cilat e kanë bërë të domosdoshme vendosjen në familje përkujdesëse. Ndërsa me dispozita ligjore garantohet po ashtu vendosja në familje e fëmijëve me nevoja të veçanta, të lënë pas dore dhe atyre me aftësi të kufizuar¹². Ligji mbi Familjen i Kosovës rregullon kompetencat dhe qëllimet e kujdestarisë për të miturit.

Krahas Ligjit mbi Familjen i Kosovës, Ligji për Shërbimet Sociale dhe Familjare llogaritet të jetë ligj plotësues i ligjit të familjes, i cili specifikon në mënyrë më të detajuar rolin e shërbimeve sociale në realizimin e formave alternative të mbrojtjes për fëmijët e braktisur dhe pa përkujdes prindëror.

Kjo analizë tregon që puna më e madhe, e cila merr edhe kohëzgjatjen më të madhe, është puna sociale dhe administrative e cila zhvillohet nga QPS për zgjidhjen e statusit të fëmijës apo punës në zhvillimin e procedurave për format e mbrojtjes përfshirë adoptimin. Në të njëjtën kohë, vonesat në zgjidhjen e statusit të fëmijës del të jetë arsyeja kryesore në aplikimin e formës së mbrojtjes të adoptimit, atëherë kur vlerësohet se nuk është i mundshëm ri-bashkimi familjar.

Mangësitë të cilat vihen re në legjislacion janë paqartësitë sa i përket afateve të përcaktuara për zgjidhjen e statusit të fëmijës, duke lënë kështu vend për interpretime të ndryshme dhe hapësira për abuzimin e tyre. Afatet e vetme të përcaktuara janë sa i përket dhënies së pëlqimit të prindërve për braktisje dhe afati kohor se kur ky pëlqim bëhet i joplotfuqishëm, në rast se fëmija nuk arrin të adoptohet¹³.

8 Neni 182, Procedura për inicimin e kërkesës për adoptim, paragrafi 3

9 Neni 169, Pëlqimi i prindërve, Ligji mbi Familjen i Kosovës

10 Neni 172, Deklarata e pëlqimit, Ligji mbi Familjen i Kosovës

11 Neni 186, Paragrafi 1, Miratimi i kërkesës për adoptim

12 Neni 204, Vendosja, Ligji mbi Familjen i Kosovës

13 Neni 172, Deklarata e pëlqimit, Ligji mbi Familjen i Kosovës

Është më se e domosdoshme të vihen afatet kohore për punën sociale tek QPS-të, qoftë përmes plotësimit ndryshimit të legjislacionit primar, apo krijimit të legjislacionit sekondar nga MPMS. Praktikant nga shtetet e tjera tregojnë që kualiteti i punës sociale është shumë më i madh, atëherë kur puna sociale bëhet në bazë të afateve kohore të përcaktuara në bazë të standardeve dhe në interesin më të mirë të fëmijës. Sa i përket procedurës së adoptimit, në praktikë, QPS ka rol crucial në realizimin e formës të mbrojtjes së adoptimit. Kjo me faktin që personat e interesuar për adoptim të fëmijës pa kujdes prindëror, kërkesën duhet ta paraqesin në Gjykatë, mirëpo Gjykata kërkesën i'a dërgon QPS-së për të dhënë vlerësimin profesional për familjen. Pra, QPS zhvillon veprimet duke përfshirë: përgatitjen e dosjes për adoptim pas zgjidhjes të statusit ligjor të fëmijës, zhvillon procedurën për vlerësim të përshtatshmërisë së prindërve adoptues përmes intervistave me prindërit potencial, takimeve vlerësuese me prindërit potencial për adoptim, trajnimin e familjeve potenciale për adoptim, etj. QPS ka në kompetencë poashtu dhe mbikëqyrjen e periudhës provuese/paraadoptuese të përcaktuar nga Gjykata. Interesi më i mirë i fëmijës përmendet në vazhdimësi tek format alternative të mbrojtjes, mirëpo asnjë dispozitë ligjore nuk përkufizon kriteret se çfarë nënkupton/përbënë interesin më të mirë të fëmijës në rastin e vendosjes për cilëndo formë të mbrojtjes, përfshirë adoptimin. Është më se e domosdoshme vënia e kriterëve/kërkesave rreth përcaktimit të interesit më të mirë të fëmijës në rastin e vendosjes për secilën formë alternative të mbrojtjes.

Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare në anën tjetër parasheh panelin¹⁴ për vendosje të fëmijëve, panel ky i cili nuk është i paraparë në kuadër të Ligjit mbi Familjen. Paneli ka funksionet: jep mendim për përshtatshmërinë e prindërve strehues familjar; jep mendim për vendosjen e fëmijëve në familje strehuese; jep mendim për vendosjen e fëmijëve në adoptim dhe përshtatshmërinë e familjeve potenciale adoptuese. Paneli për vendosjen e fëmijëve, mban një regjistër të personave, të cilët i miraton si prindër adoptues pas shqyrtimit të vlerësimeve dhe kërkimeve të bëra në emër të tij nga një nëpunës i caktuar i shërbimeve sociale¹⁵.

Paneli si trup sipas dispozitave ligjore duket të jetë organ mbikëqyrës për QPS-të i cili JEP mendim lidhur me adoptimet vendore, mirëpo në praktikë në pika të caktuara ky Panel ka edhe kompetenca ekzekutive me faktin se dokumentacioni i mbledhur për fëmijët e braktisur nga QPS duhet të miratohet fillimisht nga Paneli për të shkuar më pas në Gjykatë dhe po ashtu ngase Paneli miraton prindërit adoptues pas shqyrtimit të vlerësimeve dhe kërkimeve të bëra në emër të tij nga një nëpunës i caktuar i shërbimeve sociale. Në bazë të dispozitave dhe punës aktuale në praktikë, nuk është e qartë nëse kemi të bëjmë me një organ këshillëdhënës, një organ mbikëqyrës apo një organ me kompetenca ekzekutive për QPS-të lidhur me fëmijët e braktisur.

Sipas dispozitave aktuale të Ligjit mbi Familjen dhe Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, hallka e sistemit e përbërë prej QPS, Panelit (MPMS) dhe Gjykatës përbënë institucionet përgjegjëse për zhvillimin e procedurave dhe vendimmarrjen për format alternative për fëmijët e braktisur. Çdo zbrasëtitë ligjore, paqartësi qoftë sa i përket të kuptuarit e legjislacionit nga cilado palë, afateve ligjore, dokumentacionit dhe procedurave, ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në cilësinë e shërbimeve dhe format e mbrojtjes ofruar fëmijëve të braktisur.

¹⁴ Anëtarë të Panelit janë përfaqësues të: DMS, QPS dhe OJQ

¹⁵ Neni 10, paragrafi 10, Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare i ndryshuar Nr. 2011/04-L-081



Kapitulli 2

Analizë e sistemit
për fëmijët e braktisur

2.1 Të gjeturat e përgjithshme

Gjatë vitit 2013 në Kosovë janë braktisur gjithsej 52 fëmijë¹⁶, ndërsa raste të bartura nga vitet paraprake të fëmijëve të braktisur kanë qenë: 32¹⁷. Fëmijët e braktisur kanë kaluar dhe kalojnë nën mbrojtjen dhe kujdesin e institucioneve të Kosovës ku strehohen dhe rehabilitohen deri në realizimin e ri-bashkimit familjar ose adoptimit të tyre. Spitali, Qendra për Punë Sociale - QPS, qendra rezidenciale, kujdesi i bazuar në komunitet, familjet strehuese, familja biologjike, Paneli, Policia, Gjykata dhe familja adoptuese janë “duart” apo “sistemi” në të cilin mund të kalojë një fëmijë i braktisur brenda territorit të Kosovës.

Tabela 1

Nr.	Komunat	Fëmijët e braktisur sipas komunave për vitin 2011 (grupmosha 0-3 vjeç)	Fëmijët e braktisur sipas komunave për vitin 2012 (grupmosha 0-3 vjeç)	Fëmijët e braktisur sipas komunave për vitin 2013 (grupmosha 0-3 vjeç)
1	Gjilan	2	6	9
2	Prishtinë	7	8	9
3	Malishevë	4	4	8
4	Gjakovë	1	3	7
5	Rahovec	1	2	7
6	Lipian	2	2	6
7	Ferizaj	9	6	5
8	Drenas	2	3	4
9	Suharekë	1	2	3
10	Pejë	1	3	3
11	Mitrovicë	5	3	2
12	Vushtrri	2	2	2
13	Kamenicë	1	/	2
14	Istog	2	1	2
15	Kaçanik	/	2	2
16	Prizren	3	4	2
17	Shtime	2	/	1
18	Fushë Kosovë	/	2	1
Numri total i fëmijëve të braktisur		45	53	75

Burimi: Departamenti i Politikave Sociale dhe Familjes, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Reparti i Gjinekologjisë në QKUK si çdo repart tjetër gjinekologjik në Kosovë është institucion shëndetësor që ofron kujdesin tërësor për fëmijët e braktisur deri në momentin që Organi i Kujdestarisë i tërheq për t'i strehuar në një ndër format e strehimit alternativ. Pas marrjes së masave mbrojtëse adekuate, Organi i Kujdestarisë ka për detyrë të plotësojë dosjen dhe t'a dërgojë për pëlqim në Panel. Pasi Paneli jep pëlqimin, QPS dërgon lëndën në Gjykatë me qëllim zgjidhjen e statusit të fëmijës. Në vazhdim janë të gjeturat nga sistemi.

¹⁶ Të dhëna të marra nga Agjencioni i Statistikave Kosovë

¹⁷ Fëmijë të Kosovës nga mosha 0-18 vjeç. Të dhëna të marra nga Agjencioni i Statistikave Kosovë

2.1.1 Të gjeturat nga QKUK në Prishtinë

Me gjithë punën që bëhet në kuadër të repartit gjinekologjik, nga intervistat e bëra në këtë repart janë marrë këto të gjetura:

- **Kohëzgjatja e qëndrimit të fëmijëve të braktisur në spital nuk është gjithmonë në përputhshmëri me rregulloren dhe standardet.** Qëndrimi maksimal i fëmijëve të braktisur në spital është 21 ditë që nga dita e lindjes, afat kohor ky i vendosur nga një marrëveshje mes MPMS dhe MSH. Kjo marrëveshje sipas punëtores sociale në spital nuk respektohet gjithmonë. Janë pushimet sezonale (të dimrit ose të verës) dhe temperaturat e papërshtatshme shkaktarë që çojnë në shkeljen e kësaj marrëveshje, duke bërë që fëmijët të qëndrojnë më gjatë në këto ambiente. Për më shumë, stafi i klinikës së gjinekologjisë raportoi për periudhën shtator 2013 rastet e mëposhtme, ku nga 8 fëmijë, 5 kishin qëndruar më shumë se 21 ditë, ku vetëm 1 prej tyre ishte për arsye shëndetësore!

Tabela 2

Gjinia	Kohëzgjatja e qëndrimit të fëmijëve të porsalindur të braktisur në QKUK, shtator 2013					Gjithsej
Femër	20 ditësh (Binjake)	1 muaj e gjysmë				3
Mashkull	10 ditësh	23 ditësh	1 muajsh	1 muaj e njëzet ditë	2 muaj e gjysmë	5

Burimi: Qendra Klinike Universitare e Kosovës - QKUK, shtator 2013

- **Në klinikën e gjinekologjisë, nuk punohet në parandalimin e braktisjes së fëmijëve.** Shumica e nënave potenciale për braktisje fillimisht drejtohen në spital (për arsye aborti apo studimi të terreni). Në momentin që ato paraqiten nuk marrin ndonjë shërbim intensiv dhe gjithëpërfshirës, i cili ka për qëllim parandalimin e braktisjes. Spitali nuk ka një staf i cili punon krahas punëtores sociale me programe intensive gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe këshillimin e nënave potenciale për të braktisur foshnjat.
- **Të dhënat e kontradiktore të ofruara nga nënat në spital, përbëjnë një ndër justifikimet të cilat ndikojnë në vonesat e zgjidhjes së statusit të fëmijës.** Dokumentacioni në spital shpesh ka probleme, të dhënat nga pranimi dhe të dhënat në repartin e gjinekologjisë janë kontradiktore, shpesh dhe konfuze. Punëtorja sociale e QKUK-së tregon rastet kur ka pasur dhe deformim të informacionit që nënat lënë të dokumentuara në spital. Kjo ndodh për shkak të mbulimit të gjurmëve, mentalitetit personal dhe familjar, si dhe presionit social nën të cilin nënat janë gjendur.
- **Stafi i spitalit nuk mban me rregull dhe nuk pajis punëtorët social me të dhëna apo raporte prenatale.** Mungesa e raporteve prenatale për historinë e shtatzanisë së nënës lë pasoja në kompletimin e informacionit rreth simptomave emocionale apo shëndetësore që mund të shfaqen. Në Kosovë nënat potenciale për të braktisur janë gra/vajza, të cilat vijnë nga një mjedis shumë sfidues sa i përket aspektit social, ekonomik dhe emocional. Shoqërimi i shtatzanisë me nivel të lartë stresi, me abuzim substancash të dëmshme, dhunë,

kequshqyerje, ekspozim ndaj ambienteve jo adekuate apo presioneve të larta familjare dhe kulturore bëjnë që gjendja e dhimbshme shëndetësore dhe ajo konjitive e fëmijës të fillojë që para se ai të vijë në jetë.

- **Spitali përballat me burime njerëzore të pamjaftueshme**, tashmë ishte bërë e mundur që çdo praktikant, i cili do të specializohet si mjek, do të ketë nën punën e tij një orar të përcaktuar nga spitali për të u kujdesur për fëmijët e braktisur. Stafit që punon me fëmijët e quante lehtësim nga ana e burimeve njerëzore këtë vendim. Infermieret e repartit të gjinekologjisë shprehen se fëmijët marrin kujdesin maksimal, por ky kujdes përsëri nuk mund të jetë individual për shkak të numrit të vogël të stafit që punojnë me fëmijët e braktisur.
- **Konfidencialiteti i stafit i cili merret me fëmijët e braktisur është element kyç në shmangien e një serë rreziqesh që i kanosen mbrojtjes së fëmijës që është braktisur**, mirëpo të dhënat e marra nga intervistat me stafin e spitalit (një mjek dhe 3 infermiere) dhe punëtoren sociale kur pyeten se a ndodh t'ijepen informata të brendshme për fëmijën palës së tretë, ata kanë treguar kompetencë për punën e tyre, por kur vjen fjala për personat tjerë të ndërlidhur, ata janë përgjigjur se nuk garantojnë që ruhet rregulli etik i punës në këtë pikë.
- **Mungesa e koordinimit dhe përgjegjësisë ndërinstitucionale**, vihet re me faktin që spitali nuk lëshon komunikata me shkrim drejt QPS-ve për rastet e fëmijëve të braktisur, apo rastet potencialisht në rrezik për braktisje. Kjo gjë shkakton mungesë përgjegjësie ndërinstitucionale.

2.1.2 Të gjeturat nga SOS Fshatrat e Fëmijëve

Për mbrojtjen e një fëmije pa përkujdes prindëror, shërbimet sociale janë të obliguara që të zgjedhin formën më të përshtatshme që mbron më së miri mirëqenien dhe është në interesin e tij më të mirë të fëmijëve. Shërbimet sociale janë të obliguara që të shqyrtojnë të gjitha mundësitë që fëmija pa përkujdesje prindërore të strehohet në strehim familjar. Vetëm në rastet kur kjo nuk është e mundur, atëherë duhet të shikohet mundësia e strehimit të përkohshëm rezidencial ose komunitar.

Strehimi rezidencial dhe strehimi familjar i bazuar në komunitet në Kosovë realizohet tek SOS Fshatrat e Fëmijëve, ku në tetor 2013 kanë qenë strehuar 24 foshnje të braktisura. Nga intervista në këto ambiente dolën këto të dhëna:

- **Në SOS Fshatrat e Fëmijëve vendosen fëmijë të braktisur, shumica e të cilëve gëzojnë shëndet të plotë, por edhe fëmijë që vijnë nga spitali me probleme shëndetësore/fizike.** Një numër të konsiderueshëm të foshnjave të vendosura në QVSHM e përbëjnë foshnjat e lindura parakohe (rreth 31/32 javë), të cilat kanë pasur sindromin e mushkërive të pa zhvilluara (RDS) dhe Hemoragji intacraniale (HIC gr.II - III). Raste të tjera më të shpeshta zënë fëmijët me peshë të ulët, me keqformim të lindur të shputave, anomali të lindura në zemër, qiellzë (chielopallatoschosis), keqformime të lindura në gjymtyrë, strabizëm, etj.
- **Qëndrimi i gjatë i fëmijëve në SOS Fshatrat e Fëmijëve, përbën një ndër problematikat kyçe.** Bazuar në marrëveshjen e nënshkruar mes MPMS dhe SOS Fshatrave të Fëmijëve, maksimumi i qëndrimit të fëmijëve duhet të jetë deri në 6 muaj, me përjashtime të rasteve specifike dhe me kërkesë të punëtorit social mund të vazhdohet deri në 1 vit. Mirëpo fatkeqësisht ka fëmijë që qëndrojnë më gjatë në ambientet e SOS Fshatrave të Fëmijëve. Qëndrimi më gjatë se gjashtë muaj bënë që fëmijët të rriten në të njëjtin ambient me foshnjat e porsalindura që vinë nga jashtë. Ky lloj i jetuari me moshat më të vogla për fëmijët 1-3 vjeçar ka pasojat e regresit në zhvillim, duke bërë që ato të imitojnë në të folur dhe vepruar fëmijët më të vegjël. Ndaj, për të ndjekur interesin më të lartë të fëmijës, SOS Fshatrat e Fëmijëve detyrohen që të transferojnë foshnjat nga QVSHM në kujdes afatgjatë familjar të bazuar në komunitet.
- **Mungesë e përgjegjësisë nga ana e QPS-ve për fëmijët e braktisur të strehuar në SOS Fshatrat e Fëmijëve.** Vizitat e punëtorëve social janë të rralla, nuk janë të rregullta dhe në baza mujore siç është e paraparë me standardet minimale për shërbimet sociale, madje mund të shkojnë me muaj të tërë pa i vizituar fëmijët. Përfaqësues të kësaj organizate thonë se asnjëherë nuk kanë pasur monitorim të mirëfilltë nga ana e përfaqësuesve të QPS-ve dhe ndonjë inspektim të mirëfilltë nga MPMS. Sipas SOS Fshatrave të Fëmijëve vendosja e fëmijëve në ambientet e tyre nuk duhet të krijon një "rehati" për punëtorët social, duke bërë që fëmijët të qëndrojnë për periudha më të gjata, gjë që përbën shkelje të të drejtave të fëmijëve.
- **Mungesë inspektimi nga MPMS,** për shërbimet e ofruara nga OJQ-të dhe QPS-të për fëmijët e braktisur nën mbrojtjen institucionale. Deri më tani, nuk ka pasur ndonjë proces inspektimi nga MPMS, megjithëse këtë kompetencë e ushtron në bazë të Ligjit mbi Shërbimet Sociale dhe Familjare.

2.1.3 Të gjeturat nga familjet strehuese

Konventa e OKB-së mbi të Drejtat e Fëmijëve, qartë thekson që të gjithë fëmijëve, përfshirë fëmijët e braktisur duhet t'iu mundësohet që të jetojnë në familje.

Sipas akteve nënligjore është përcaktuar që familjet strehuese¹⁸ që ofrojnë strehim për fëmijët pa përkujdesje prindërore e që nuk janë farefis i fëmijës, marrin 150 EUR për fëmijë në muaj. Kjo shumë dallon për fëmijët me aftësi të kufizuara të strehuar në familje strehuese ku familjet në emër të përkujdesjes për fëmijët marrin nga 250 EUR në muaj për fëmijë. Këto familje strehuese të gjitha trajnohen nga stafi profesional i QPS-ve dhe organizatave të tjera që ofrojnë shërbime sociale ku një ndër më të përfshirat është Amici Dei Bambini.

Nga intervistat e marra me përfaqësues të këtyre familjeve dhe me organizatën Amici Dei Bambini, del se:

- **Strehimi familjar nuk është i shtrirë në të gjitha komunitat e Kosovës dhe nuk plotëson kërkesat për strehim të fëmijëve pa përkujdesje prindërore.** Strehimi familjar ka shtrirje në vetëm 22 komuna nga gjithsej 38 komuna sa ka Kosova, përdërisa numri familjeve strehuese është 43¹⁹.
- **Pagesa për fëmijët në strehim familjar pavarësisht moshës dhe nevojave të tyre të ndryshme është e njëjtë dhe gjithashtu e pa mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet e përkujdesjes për fëmijën.** Nuk ka një përshkallëzim për sa i përket pagesave për familjet strehuese sipas moshës dhe nevojave të fëmijëve, dallim sa i përket shumës së pagesës bëjnë vetëm familjet të cilat strehojnë fëmijë me aftësi të kufizuara.
- **Familjet strehuese në Kosovë nuk janë të përgatitura në mënyrë adekuate për t'u përkujdesur për fëmijët me nevoja të ndryshme apo të kategorive të ndryshme.** Përveç mungesës së familjeve strehuese, si pasojë e mos përgatitjes adekuate të familjeve strehuese për t'u përkujdesur për fëmijët me nevoja të ndryshme përbënë një ndër arsyt kryesore për QPS-të që për raste të caktuara ta shohin si alternativë më të mirë strehimin rezidencial.
- **Familjet strehuese nuk realizojnë asnjë përfitim social apo shëndetësorë në emër të qenurit familje strehuese dhe në këtë mënyrë rrezikohet qëndrueshmëria e tyre.**
- **Fëmijët nga spitali në shumë raste shkojnë në familje strehuese me probleme shëndetësore specifike.** Familjet strehuese të pyetura për këtë analizë tregojnë se, arrijnë të vërtetojnë lehtësisht foshnjat që vinë nga spitali, këto foshnje kanë deformime të kockës së kokës, të pjesës së qafës si dhe paraqesin infeksione të ndryshme të lëkurës, sidomos tek pjesa e qafës dhe mes këmbëve.
- **Familjet strehuese nuk janë në gjendje të vlerësojnë rolin e QPS-së për kujdesin ndaj fëmijëve.** Këto familje mbështetjen më të madhe trajnuese dhe psikosociale e marrin nga organizata Amici dei Bambini, e cila në bashkëpunim me QPS-të ka mundur të inkuadrojë psikologë që të punojnë si grup multidisiplinar me Organin e Kujdestarisë.

¹⁸ Familje strehuese, quhet çdo familje në Kosovë, e kontraktuar nga shteti për të strehuar dhe ushtruar mbrojtje dhe kujdes alternative fëmijët pa përkujdesje prindërore

¹⁹ Të dhëna të marra nga Amici Dei Bambini dhe të konfirmuara nga MPMS

2.1.4 Të gjeturat nga Qendrat për Punë Sociale - QPS

Qendra për Punë Sociale është Institucion Publik profesional në nivel komunal, kompetente për mbrojtjen e qytetarëve në gjendje të nevojës sociale, përgjegjës për mbrojtjen e interesave të fëmijëve. Pas paraqitjes të rastit për braktisjen e fëmijës të referuar nga spitali, komuniteti, policia, etj, QPS-ja kompetente brenda ditës duhet të bëjë evidentimin e rastit. QPS është përgjegjëse për menaxhimin e rastit të fëmijës, vlerësimin fillestar, ndërmarrjen e të gjitha masave dhe veprimeve për mbrojtjen e fëmijës së braktisur, përfshirë sigurimin e strehimit të përkohshëm pas referimit nga spitali, caktimin e kujdestarit të përkohshëm, regjistrimin e fëmijës në zyrën e gjendjes civile brenda afatit kohor prej 30 ditëve, hartimin e planit të përkujdesjes, zhvillimin e të gjitha aktiviteteve për bashkimin familjar të fëmijës me prindërit biologjik, ndërsa kur kjo nuk është e mundshme vendosjen e formave alternative të mbrojtjes për fëmijën, i cili para marrjes së vendimeve duhet të konsultohet me kujdestarin ligjor të fëmijës.

Adoptimi është një ndër format themelore për mbrojtjen e fëmijëve të braktisur, atëherë kur fëmija nuk mund të kthehet në familjen e tij/saj biologjike, përmes të cilës fëmijës i ofrohet një familje e përhershme ligjore me të njëjtat të drejta dhe detyrime që ekzistojnë mes prindërve dhe fëmijëve biologjik.

Tek procedura e adoptimit, QPS ka rol kyç në realizimin e kësaj forme të mbrojtjes. Kjo me faktin që, personat e interesuar për adoptim të fëmijës pa kujdes prindëror, kërkesën duhet ta paraqesin në Gjykatë, mirëpo Gjykata kërkesën i'a dërgon QPS-së për të dhënë vlerësimin profesional për familjen. Pra, QPS zhvillon të gjitha veprimet duke përfshirë: përgatitjen e dosjes për adoptim pas zgjidhjes të statusit ligjor të fëmijës, zhvillon procedurën për vlerësim të përshtatshmërisë së prindërve adoptues përmes intervistave me prindërit potencial, takimeve vlerësuese me prindërit potencial për adoptim, trajnimin e familjeve potenciale për adoptim, etj.

Tabela 3

Komuna	Numri i fëmijëve të braktisur	Numri i fëmijëve në strehim familjar	Numri i fëmijëve në SOS Fshatrat e Fëmijëve	Numri i fëmijëve në QKUK	Numri i fëmijëve me status të zgjidhur
Prishtinë	10	6	4	0	3
Fushë-Kosovë	3	1	1	1	3
Mitrovicë	1	1	0	0	1
Ferizaj	5	3	1	1	2
Gjakovë	0	0	0	0	0
Prizren	3	1	1	1	0

Burimi: 6 Qendrat për Punë Sociale. Të dhënat e numrit të fëmijëve të braktisur në Kosovë dhe vendosja e tyre, shtator 2013

Nga intervistat e zhvilluara me 6 QPS të përzgjedhura për këtë analizë doli se:

- **Fëmijët e braktisur në Kosovë të moshës 0-3 vjeç në të shumtën e rasteve referohen tek QPS nga spitali.** Ka raste të veçanta që ka vetëreferent (prindërit ose të afërmit) apo policia.
- **Humbja e gjurmëve të prindërve biologjik që lindin fëmijët në spital, mbetet përgjegjësi e papërcaktuar.** Një ndër problematikat parësore mbetet atëherë kur nëna largohet pa lajmëruar nga spitali. Në këto raste sipas ligjit, Organi i Kujdestarisë duhet t'a kërkojë nënën deri në 1 vit. Për aq sa nëna ngelet e panjohur brenda vitit të parë aq zgjatet dhe periudha e qëndrimit të fëmijës pa status të zgjidhur!
- **Tendencë e QPS-ve për të i dërguar fëmijët e braktisur fillimisht në ambientet e SOS Fshatrave të Fëmijëve.** Këtë gjë punëtorët social, e arsyejnë me faktin e mungesës së kapaciteteve dhe numrit të vogël të familjeve strehuese për të pranuar dhe për t'u kujdesur për fëmijët me nevoja të veçanta dhe me probleme shëndetësore.
- **Arsyeja e vonesave në zgjidhjen e statusit të fëmijës apo adoptimin e tyre shpesh lidhet me gjendjen shëndetësore, me aftësinë e kufizuar, moshën e fëmijës apo për shkak të implikimeve/rrethanave familjare të fëmijës së braktisur.** QPS-të shprehën se fëmijët me aftësi të kufizuara rrinë për një kohë të gjatë në listën e pritjes për adoptim dhe zakonisht shkojnë në adoptim ndërkombëtar. Nuk mohohen rastet kur procedurat rreth zgjidhjes së statusit të fëmijës bllokohen për shkak të implikimeve/rrethanave familjare²⁰. Rastet specifike sipas QPS-ve përbëjnë atëherë kur nëna tregon babain, e babai nuk pranon fëmijën. Këtu lindin procedura të reja e që mund të shkojnë deri në vërtetim të atësisë përmes testit të ADN-së. Testi i ADN-së është e pamundur që të realizohet brenda territorit të Kosovës, realizmi i këtij testi ka kosto të lartë jashtë vendit. Disa nga lëndët e fëmijëve të braktisur janë zvarritur me vite të tëra në gjykatë në mungesë të vërtetimit të atësisë, ku rast konkret është në komunën e Gjakovës, ku një nga rastet vazhdon të zvarritet në gjykatë tash e 3 vite!
- **Mungesë e kuptimit të ligjit dhe paqartësi kompetencash rreth zhvillimit të procedurave për zgjidhjen e statusit të fëmijës së braktisur dhe procedurave të adoptimit vihet re në të gjitha komunat ku është bërë kjo analizë.** Inicimi i procedurave lidhet fillimisht me marrjen e deklaratës së parë të nënës. Sipas udhëheqëses së shërbimeve sociale në Prizren, menaxheri i rastit ka për detyrë të kërkojë minimumi tre deklaratat për braktisje nga nëna të mbledhura brenda 6 muajve për të plotësuar dosjen e rastit. Këto deklaratat nuk janë të vlefshme për gjykatën por vetëm për rregullim të brendshëm të procedurave në QPS, këto deklaratat janë:

Deklarata I - vjen në momentin që kujdestari ligjor takohet me nënën e fëmijës e cila është potencial për braktisje, kjo deklaratë de juro nuk është e vlefshme, por hapë procedurat e QPS për të iniciuar rastin;

Deklarata II - merret nga menaxheri i rastit pas 40 ditëve, kjo është përsëri një deklaratë që nuk është e vlefshme jashtë zyrave të QPS-së, por që e bën të qartë qëndrimin e nënës për braktisjen e fëmijës;

Deklarata III - është dëshmi për qëndrimin përfundimtar të prindit/prindërve, QPS-të bazuar në këtë deklaratë dërgojnë çështjen në Panel;

²⁰ Procedurat e braktisjes së fëmijës në rastet kur njëri prind ndodhet jashtë shtetit, apo kur ka çështje kontestimore

Në Gjykatë nëna/babai jep deklaratë vetë dhe vetëm kjo është e vlefshme për të i marrë nënës/babait të drejtën prindërore.

Ndërsa, sipas udhëheqësit të shërbimeve sociale të Komunës së Gjakovës tri deklaratat merren sa më shpejt që është e mundur pa ndonjë afat të përcaktuar dhe ato i paraqiten Panelit. Pa këto deklaratat dosja mbetet e paplotësuar për gjykatën.

Kjo analizë tregon që në praktikë ka shumë konfuzion nga të gjitha palët sa i përket dhënies së deklaratës, numrit dhe llojit të deklaratës së pëlqimit. Sipas QPS-ve ligji nuk është i qartësuar se para kujt nëna duhet t'a japë deklaratën. Aktualisht, QPS-të vazhdojnë të kërkojnë minimumi nga 3 deklaratat nga nëna, më arsyetimin e plotësimit të dokumentacionit/dosjes për panel dhe kjo arsyetohet si punë sociale me nënën për ribashkim familjar. Vlen të përmendet që numri i deklaratave, lloji dhe afatet kohore për marrjen e këtyre tri deklaratave nuk janë të përcaktuara në kuadër të ndonjë akti nënligjor, duke vërtetuar që më shumë ka të bëjë me një praktikë tashmë të krijuar nga vetë QPS-të. Përderisa Ligji mbi Familjen nuk përmend askund tri deklaratat, mirëpo përcakton qartë që pëlqimi duhet t'i deklarohet gjykatës dhe bëhet i plotfuqishëm në kohën e dorëzimit.

Mos respektimi i afateve kohore nga institucionet e përfshira është një fakt tjetër në vonesat për zhvillimin e procedurave për adoptimin e fëmijëve. Sipas QPS-së në Fushë Kosovë, pasi regjistrohet fëmija në spital dhe vlerësohet nëse do të shkojë në strehim rezidencial apo në strehim familjar, përgatitet dosja për të shkuar në Panel. Paneli nuk mblidhet vetëm për rastet e fëmijëve të braktisur, duke bërë kështu që të mblidhen disa lëndë për të u shqyrtuar, ku këto vonesa shkojnë deri në një ose dy muaj. Pëlqimi i Panelit për të çuar lëndën në Gjykatë është pikë kyçe, pa këtë pëlqim QPS-ja nuk mund të i drejtohet Gjykatës.

- **Vonesat në Gjykata sipas punëtorëve social janë problem, kjo me rastin që ua kanë kthyer dokumentacionin si lëndë të pa kompletuar, me kërkesën për plotësim dokumentacioni.** Plotësimi i dokumentacionit është faza më e rëndësishme për QPS-të dhe pikërisht për këtë pjesë ato harxhojnë energjinë dhe kohën më të madhe. Lihet të kuptohet se është pikërisht ky plotësim dokumentacioni i cili bënë që të gjithë akterët të justifikohen për vonesat e rasteve për adoptim.
- **QPS-të përballen me mbingarkesë të lëndëve, ku mesatarja e rasteve që një menaxher menaxhon në periudhë 1 vjeçare mund të kalojë edhe numrin prej 100 lëndëve.** Mungesa e burimeve njerëzore bën që Organi i Kujdestarisë të mos mund të japë maksimumin e mundshëm për situatat e fëmijëve të braktisur²¹.
- **Shterje profesionale apo mungesë motivimi tek zyrtarët e shërbimeve sociale dhe familjare.** Kjo analizë tregon që eksperiencia dhe njohuritë e punëtorëve social nuk mungojnë në çështjet e menaxhimit të rasteve në përgjithësi dhe sidomos të rasteve për fëmijët e braktisur, por ajo që vihet re është një shterje profesionale apo mungesë motivimi, që sipas tyre ka ardhur si pasojë e mbingarkesës me raste. Kjo ndikon domosdoshmërisht në kualitetin e shërbimeve ofruar karshi fëmijëve të braktisur.

21 Për më shumë, QPS-të ofruan edhe mesataren e rasteve të një menaxheri brenda vitit: QPS Prishtinë rreth 100 raste, QPS Prizren 30 – 80 raste, QPS Ferizaj rreth 100 raste, QPS Fushë Kosovë 70 raste, QPS Gjakovë 300 raste dhe QPS Mitrovicë rreth 15 raste

2.1.5 Të gjeturat nga Paneli

Paneli për Vendosjen e Fëmijëve në Strehim Familjar dhe Adoptim - është trup profesionale që mbikëqyrë respektimin e procedurave ligjore dhe profesionale për vendosjen e fëmijëve në strehim familjar dhe adoptim, i cili funksionon në kuadër të MPMS. Paneli përbëhet prej 7 anëtarëve, 4 prej tyre janë anëtarë jashtë MPMS-së.

Për fëmijën me status ligjor të zgjidhur i gatshëm për adoptim, anëtarët e Panelit tregojnë se në praktikë QPS njofton zyrtarin përgjegjës në DPSF, i cili mirëmban regjistrin unik të fëmijëve me status të zgjidhur potencial për adoptim dhe regjistrin unik të prindërve të vlerësuar pozitivisht dhe potencial për adoptim. QPS-ja merr rekomandimin nga zyrtari përgjegjës në DPSF, për tri (3) familjet e para me radhë në pritje për adoptim sipas regjistrin unik të Panelit. Pastaj, QPS vendos për përzgjedhjen e njëres nga tri familjet/prindërit potencial për adoptim të propozuara nga zyrtari përgjegjës në DPSF, që është më e përshtatshme dhe në interesin më të mirë për fëmijën.

Organi i Kujdestarisë, pas marrjes të mendimit pozitiv nga Paneli e bënë iniciimin e procedurës për adoptim të fëmijës së bashku me prindërit potencial adoptues, pranë gjykatës themelore.

Nga intervistat e zhvilluara me anëtarë të Panelit për këtë analizë, të gjeturat janë:

- **Braktisja e fëmijëve nuk është se ka pasur rritje vitet e fundit, është një trend pothuasje i njëjtë me një mesatare prej 50 fëmijëve të braktisur brenda vitit.** Përderisa krahasuar me vitet e pasluftës, numri i fëmijëve të braktisur ka rënë dukshëm. Anëtarë të panelit përmendin vitin 2002 ku numri i fëmijëve të braktisur ishte mbi 100. Megjithatë ata theksojnë që duhet të punohet sa më shumë në parandalim që numri i braktisjes të jetë sa më i ulët.
- **Kërkesa e aplikuesëve për adoptim është tre herë më e madhe se numri i fëmijëve të braktisur.** Anëtarë të Panelit shpjegojnë që aplikuesit duhet të presin në radhë sipas regjistrin unik të prindërve të vlerësuar pozitivisht, ku ndodh që aplikuesit (çiftet bashkëshortore) duhet të presin edhe me nga dy vite për të ardhur në radhë. “Kërkesat janë të mëdha për adoptim, prandaj Kosova fatmirësisht nuk përballet me problemin e mungesës së kërkesave për adoptim, për më shumë kemi rastin edhe të përzgjedhjes së familjeve gjatë vlërsimit të tyre sipas radhës së regjistrin unik”.
- **Nuk ka një kohëzgjatje të përcaktuar për procedurat për zgjidhjen e statusit të fëmijës dhe procedurave për adoptim.** Sipas anëtarëve të Panelit secili rast është i veçantë dhe trajtohet si i tillë. Fillimisht bëhen përpjekjet për bashkim familjar e pastaj për zgjidhjen e statusit të fëmijës. Deklarata për braktisje bëhet vetëm pas 8 javësh. Ka raste kur nëna kërkon kohë më të gjatë duke shpresuar në rrethana më të mira. Nënës i jepet përparësi absolute nëse ka shenja se mund ta marrë fëmijën.
- **Paneli nuk vonon lëndët për mendim, “Paneli takohet sa herë ka nevojë, pra nuk kemi datë fikse që duhet ta presim, një ditë më pas Paneli fton QPS-të t’i marrin lëndët”,** është ky informacion i ofruar nga anëtarë i Panelit.
- **Çështja e deklaratave të nënës duhet të kuptohet si punë sociale e organit të kujdestarisë për ribashkimin familjar të fëmijës me nënën biologjike.** Sipas anëtarit të Panelit, çështja e deklaratave nuk duhet të shkaktojë konfuzion tek QPS-të, meqenëse varësisht nga rasti, numri i deklaratave mund edhe të variojë, përderisa thekson që nuk duhet të ketë abuzime dhe vonesa në aspektin kohor “në emër të marrjes” së tri deklaratave.

- **Rastet e fëmijëve me status të pazgjidhur ndër vite janë kryesisht raste specifike të fëmijëve të braktisur, atëherë kur ka kontest mes palëve, apo kur të dy prindërit janë të panjohur.** Anëtarë të Panelit theksojnë që ka raste kur nëna tregon babain e “babai” nuk pranon fëmijën që nënkupton hapjen e procedurave për vërtetimin e atësisë, apo rastet tjera kur të dy prindërit janë të panjohur. Në rastin e kësaj të fundit, sipas ligjit QPS duhet të presë për më shumë se një vit që të paraqiten prindërit, ku pas një viti mund të iniciojë procedurat për adoptim. Megjithatë kjo nuk arsyeton rastet e fëmijëve të braktisur me status të pazgjidhur të cilët qëndrojnë me nga tre vite në format e alternative të strehimit (megjithëse në numër të vogël në raport me numrin e përgjithshëm të fëmijëve të braktisur).
- **Asnjë rast i fëmijës së braktisur me aftësi të kufizuara nuk është adoptuar në Kosovë gjatë vitit 2013, fëmijët me aftësi të kufizuara kryesisht shkojnë në adoptim ndërkombëtar.** Anëtarë të Panelit spjegojnë që është pothuajse e pamundur që tani për tani fëmijët e braktisur me aftësi të kufizuara të adoptohen me adoptim vendor, qoftë fëmijët me ndonjë aftësi të lehtë të kufizuar, “Për shkak të mentalitetit, çiftet nuk janë të gatshme të adoptojnë fëmijët me aftësi të kufizuara në Kosovë. Nevoja për sensibilizim të masës në këtë drejtim është jashtzakonisht e madhe”. Sipas ligjit, adoptimi ndërkombëtar realizohet vetëm kur janë shterrur të gjitha mundësitë për t’u adoptuar brenda Kosovës dhe kur kjo shkon në interesin më të mirë të fëmijës.
- **Vështirësitë e Panelit lidhen poashtu me adoptuesit potencial që punojnë dhe jetojnë jashtë Kosovës, të cilët dëshirojnë të adoptojnë me procedura vendore, meqë kanë edhe nënshtetësinë e Kosovës.** Legjislacioni dhe Konventa e Hagës për Birësim i detyron këta prindër që të aplikojnë me procedura ndërkombëtare e që është garancion se nëse adoptojnë, pa problem lëvizin me fëmijë në vendin ku janë duke jetuar. Në këto raste, Paneli e ka jashtzakonisht të vështirë të dijë diçka për këto familje nëse QPS nuk ka dhënë detaje. Përfaqësues të panelit theksojnë që adoptimi vendor është prioritet në raport me adoptimin ndërkombëtar.
- **Mos unifikimi i procedurave mes QPS-ve dhe Gjykatave pas kalimit të kompetencave për themelimin e adoptimeve tek Gjykatat, ka shkaktuar konfuzion mes palëve.** Është më se e nevojshme të mbahen takime të përbashkëta mes QPS-ve dhe Gjykatave për të unifikuar procedurat sidomos sa i përket kompletimit të lëndëve, për të minimizuar kohëzgjatjen gjatë përgatitjes së lëndës dhe zhvillimit të procedurave.

2.1.6 Të gjeturat nga Gjykatat Themelore

Autoriteti kompetent për adoptim dhe procedura e adoptimit është në kompetencë të Gjykatës Themelore. Gjykata mund të kërkojë këshilla nga Organi i Kujdestarisë gjatë marrjes së vendimit mbi adoptim.

Nga intervistat e zhvilluara me gjyqtarët e përzgjedhur për këtë analizë doli se:

- **Legjislacioni i cili lidhet me mbrojtjen e fëmijëve të braktisur dhe me adoptimin e tyre sipas gjyqtarëve është në pajtueshmëri me interesin më të mirë të fëmijës dhe i përshtatshëm për kontekstin e Kosovës.**
- **Lëndët e fëmijëve të braktisur dhe atyre pa përkujdes prindëror merren gjithmonë me prioritet të lartë,** duke respektuar afatet ligjore dhe pa vonesa, me gjithë mbingarkesën e punës që kanë si pasojë e numrit të madh të lëndëve të përgjithshme në raport me lëndët statusore si dhe numrit të vogël të gjykatësve. Vonesa mund të ketë tek lëndët specifike (psh. në rastet kur duhet vërtetuar atësia përmes testit të ADN-së) të cilat janë shumë të rralla në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të fëmijëve të braktisur.
- **Lëndët e pakompletuara për zgjidhjen e statusit të fëmijës apo për adoptim, të parashtruara në Gjykatë nga QPS-të del të jenë problematike e cila shkakton vonesa në proces. Sipas gjyqtarëve Paneli nuk është gjithmonë azhur në lidhje me dokumentacionin që i sugjeron QPS-ve për të kompletuar.** Në disa prej lëndëve të pranuar nga Gjykatat, ka mungesë në dokumentacion. Shembull i kësaj është rasti i Gjykatës Themelore të Prishtinës, ku për vitin 2012 nga 13 lëndët e parashtruara nga QPS-të vetëm një lëndë ka qenë e mirë kompletuar, të tjerat janë kthyer mbrapsht për plotësim dokumentacioni si lëndë të pa kompletuara tek QPS-të.
- **Konfuzion vazhdon të mbetet çështja e deklaratave të nënës të marra nga QPS-të.** Ka raste kur gjyqtarët pranojnë nga 3 apo 4 deklaratat të ndryshme dhe kontradiktore që variojnë nga rrethana të ndryshme momentale të nënës, duke krijuar konfuzion tek gjyqtarët dhe jo siguri se cila prej deklaratave është e plotfuqishme. Deklaratat shpesh nuk paraqesin dëshmi dhe fakt, janë të mangëta në përmbajtje dhe cilësi. Deklarata e nënës përbën dëshminë kryesore për gjyqtarët, ku pa një deklaratë të mirëfilltë nuk mund të procedohet tutje. Gjyqtarët kërkojnë që QPS-të mos të dërgojnë nga 3 apo 4 deklaratat të nënës në kuadër të lëndës, një deklaratë është e mjaftueshme, mirëpo që ajo deklaratë të jetë e plotfuqishme.
- **Periodha paraadoptuese e përcaktuar sipas Ligjit për Familjen brenda tre muajve, jo gjithmonë caktohet nga gjyqtarët.** Ka raste kur gjyqtarët për shkak të përfshirjes emocionale, nuk shqiptojnë fare periudhën para adoptuese dhe bëjnë themelimin e adoptimit brenda 4 - 5 ditëve!
- **Praktikat e punës së gjyqtarëve lidhur me lëndët e fëmijëve të braktisur nuk janë të unifikuara.** Gjyqtarja në Prishtinë thekson që ka nevojë për takime të përbashkëta mes gjyqtarëve nga Komuna të ndryshme bashkërisht edhe me QPS-të, me qëllim të unifikimit të praktikave qoftë sa i përket lëndëve të fëmijëve të braktisur apo themelimit të adoptimeve.



Kapitulli 3

Këndvështrimi i përgjithshëm
psiko-fizik dhe social

3.1 Këndvështrim i përgjithshëm i zhvillimit të fëmijëve të braktisur 0-3 vjeç

Që në fazat e para të shtatzanisë, embrioni fillon të lidhet me nënën emocionalisht. Kjo kimi nuk është vetëm nga ana e zhvillimit fizik por edhe nga ana e përjetimeve emocionale, e përkthyer më qartë kjo, gjithçka që nëna përjeton embrioni është i ndikuar nën efektin e këtyre emocioneve.

Ndikimi i gjendjes emocionale jo të mirë, sjelljet e papërshtatshme, abuzimi me substanca të dëmshme, kanë efektin e tyre në shëndetin fizik, mendor dhe emocional të embrionit apo fetusit më vonë. Por pavarësisht përjetimeve emocionale të nënës, duhet të pranojmë që fëmija sa është në barkun e saj, fizikisht gjendet në një ambient të sigurt.

Historia e shtatzanisë duhet të njihet sa në aspektin holistik aq edhe në detaje sepse mund të ndihmojë në trajtime eventuale mjekësore apo psikosociale të foshnjës por edhe nënës.

Momenti i lindjes është një proces cili shoqërohet me dinamika të mëdha për foshnjën. Që nga momenti i parë që foshnja vjen në kontakt me botën vazhdon ndërveprimin dhe komunikimin. E panjohura me të cilën përballet në momentet e para shoqërohet me traumë në vetvete, sepse, foshnja e sapolindur fizikisht dhe emocionalisht nuk e ka të kuptuarin për të qenit i ndarë si person, kështu që ndryshimi i temperaturës, intensiteti i zërit, dritat, pozicioni fizik, ndryshimet fiziologjike dhe kontaktet e tjera me materien e jashtme shoqërohen me ndjesi të forta dhe të palakmueshme emocionale dhe fizike.

Në fazën e parë të zhvillimit të foshnjës (0-18 muajsh), sipas Erik Erikson²² zhvillohet besimi kundrejt mosbesimit. Foshnja vjen në këtë jetë totalisht mosbesues dhe jemi ne ata që duhet të e ndihmojmë atë të krijojë besimin për botën dhe këtë e realizon personi që është më i afërt me foshnjën, ai që e ushqen, e pastron, i buzëqesh, dhe i krijon komplet komoditetin e mundshëm për t'ia larguar paretin dhe pasigurinë nga stimujt e panjohur, që përsëri në rastin më ideal është nëna dhe babai.

Për të kaluar në zhvillimin fizik të foshnjës në këtë fazë, dihet që pjesa kockore e kokës nuk është plotësisht e formuar dhe ka trajtë të butë²³. Muskujt e qafës së foshnjës janë të buta dhe gjatë 3 muajve të parë foshnja kërkon kujdes të veçantë të pozicionit të qafës²⁴. Gjymtyrët çdo ditë e më shumë kërkojnë të zhvillohen dhe foshnja ka nevojë për stimulim e lëvizje në mënyrë të zhvillojë aftësitë motorike. Kujdesi higjienik duhet të jetë në nivel të lartë në mënyrë që të evitohen infeksionet pasi lëkura nuk e ka arritur përshtatshmërinë e plotë me ambientin.

Duke qenë se zhvillimi fizik dhe ai emocional i foshnjës shkojnë si një i vetëm dhe janë direkt të lidhura me praninë e personit që kujdeset më së shumti për fëmijën, dihet se mënyra se si shprehet ky kujdes ka ndikimin e vet në këtë proces. Prandaj edhe nevoja e foshnjës për përkrahje dhe kujdes nuk është vetëm fizike.

²² Fazat e zhvillimit të personalitetit – Eric Erikson

²³ R. L. Altman, J. Canter, P. A. Patrick, N. Daley, N. K. Butt dhe D. A. Brand (2011). Parent Education by Maternity Nurses and Prevention of Abusive Head Trauma. PEDIATRICS, 128 (5), e1164-e1172. Doi: 10.1542/peds.2010-3260, <http://pediatrics.aappublications.org/content/128/5/e1164.full.html>

²⁴ R. L. Altman, J. Canter, P. A. Patrick, N. Daley, N. K. Butt dhe D. A. Brand (2011). Parent Education by Maternity Nurses and Prevention of Abusive Head Trauma. PEDIATRICS, 128 (5), e1164-e1172. Doi: 10.1542/peds.2010-3260, 4. 4 <http://pediatrics.aappublications.org/content/128/5/e1164.full.html>

Zhvillimi i fëmijës 18 muajsh deri në 3 vjeç është një fazë e rëndësishme e krijimit të personalitetit që përsëri, sipas Erikson, është krijimi pavarësisë kundrejt turpmit dhe dyshimit. Janë viti i dytë dhe i tretë i jetës ku fëmija duhet të mësohet dhe e ka të nevojshme të pavarësohet. Sipas tij nëse gjatë kësaj faze fëmija nuk ndihmohet ta kalojë në mënyrë të shëndetshme personaliteti i tij ka probabilitet të shoqërohet gjithë jetën me ndjenjën e varësisë, turpmit dhe dyshimit.

Nëse këtë përshkrim të përgjithshëm të zhvillimit normal që nga momenti i ngjizjes deri në moshën tre vjeçare do ta krahasonim me kushtet që kanë fëmijët e braktisur të cilët një pjesë të kësaj periudhe e kalojnë në institucione rezidenciale, spital apo shtëpitë në komunitet, duhet të pranojmë që kahjet e zhvillimit normal janë të ndryshme. Fëmijët që kalojnë një periudhë të jetës së tyre brenda tre viteve të para të jetës në institucion nuk i gëzojnë dot këto komoditete fillestare të domosdoshme në periudhën e duhur kohore.

Pasojat lidhen direkt me ndjenjën e të qenit i sigurt, fëmija zhvillon aftësi të tjera për të mbijetuar të cilat janë larg sigurisë. Mungesa e sigurisë në muajt e parë automatikisht shoqërohet më vonë me mungesë besimi. Janë siguria dhe besimi dy shtylla të forta në të cilat çdo personalitet mbahet fort tek vetja dhe tek shoqëria për të gjetur mënyrën e ndërveprimit dhe funksionimit në shoqëri.

Studimet e fundit²⁵ tregojnë se mos zhvillimi i duhur i aftësive motorike dhe mos zhvillimi i ndjenjës së shëndetshme të sigurisë dhe të besimit në këtë fazë ka pasoja jo vetëm kognitive, sjellore por edhe fizike. Këto pasoja shkojnë deri në mosaktivizim të plotë të hemisferës së djathtë të trurit. Shumë fushata sot ndërmerren në botë për fëmijët që kalojnë tre vitet e para të jetës në institucione, kjo vetëm për të ruajtur funksionimin e shëndetshëm të kësaj pjese të trurit.

3.2 Efektet psikoshëndetësore

Shtatëzania është kjo periudhë sa e rëndësishme për të u ditur në të ardhmen aq edhe delikate për të u nxjerr dhe për të u trajtuar. Fatkeqësisht në Kosovë, raportet paralindjes nuk është se janë praktikë e punës, duke lënë kështu boshllëkun e parë dhe njëkohësisht mbulimin e një serë problemesh të cilat mund të kenë nevoja imediate për trajtim në të ardhmen e fëmijës. Në spital gjatë kohës së intervistimit disa nga foshnjat kishin probleme shëndetësore ku shkaku mund të jetë shtrëngimi i barkut apo sjelljet vetëmohuese që nëna shtatëzanë stimulon.

Edhe pse ekipi i punës në Spital bën një punë të shkëlqyer me muaj të tërë duke i mbajtur këta fëmijë, përsëri kujdesi i tyre ngelet vetëm në nivel institucional, duke mos mundur të u japin këtyre fëmijëve nevojat bazë për zhvillimin fizik, emocional dhe ndijor i cili është tepër i vrullshëm në këtë periudhë. Të jetuarit gjatë në një ambient spitalor, kolektiv dhe me mungesë të një kujdestari lë pasoja në të tre aspektet e këtij zhvillimi.

Trajtimi ushqimor është trajtim i një foshnje në spital. Të ushqyerit si në spital ashtu edhe në SOS Fshatrat e Fëmijëve raportohet të jetë me orar dhe sipas plan programit të dietës ushqimore. Në spital, duke e marr parasysh që foshnjat qëndrojnë jo për periudha të gjata, ato ushqehen vetëm me qumësht formulë dhe ushqehen çdo 3 orë, ndërsa në SOS Fshatrat e Fëmijëve u krijohet plan programi i dietës ushqimore në përputhshmëri me moshën dhe zhvillimin e fëmijës.

²⁵ CMSD 636 Neuropathologies of Language and Cognition, chapter 3. <http://www.csuchico.edu/~pmcaffrey/syllabi/SPPA336/336unit13.html>

Mos pasja e një lidhje me një person dhe mos dhënia mundësisë për të u njohur me fytyrën që kujdeset bën që këta fëmijë të mos krijojnë ndjenjat bazë të personalitetit të tyre, siç janë siguria dhe besimi, pasojat çojnë deri në dëmtime neuropsikobiologjike të hemisferës së djathtë të trurit. Rikuperimet nga pasoja të tilla asnjëherë nuk arrijnë një stad optimal dhe njëkohësisht kanë kosto të madhe si në shoqëri dhe në individ.

Nëse një fëmijë e kap mosha 3 vjeç të pa adoptuar, ndjenjat e inferioritetit, të të ndierit i padashur, ndjenjat e pasigurisë për të ardhmen dhe ndjenja e mosbesimit kanë probabilitet të gërshetohen së bashku për të krijuar një profil, i cili do duhet të mbijetojë në shoqëri me stërmundime të mëdha. Këto stërmundime janë akoma më të mëdha nëse shoqërohen dhe me problematikat fizike.

Mungesa e vullnetit për të i nxjerr fëmijët që akomodohen në institucione rezidenciale brenda 6 muajsh thëllon problematikën akoma më shumë. Mosdhënia e mundësisë që të njohë ambientin familjar vitet e para të jetës, mos dhënia mundësisë për të ndier ngrohtësinë familjare, mos dhënia mundësisë për të u lidhur me një person të besueshëm, mosdhënia e mundësisë për të marr modele të plota të skemave familjare dhe mos dhënia mundësisë së një kujdesi holistik që vetëm familja e jep, bën që fëmija të vazhdojë jetën pa orientime dhe me thëllim problematikash në zhvillim.



Kapitulli 4

Rekomandimet

4.1 Rekomandimet afatshkurtra

- **Urgjentisht të ndryshohen praktikat e dertanishme të personelit të spitalit dhe QPS-ve, që t'i mbajnë fëmijët në spital në kundërshtim me rregulloren e nënshkruar mes MPMS dhe MSH "për shkak të pushimeve sezonale, gjatë sezonit të dimrit apo verës, për shkak të motit apo temperaturave të larta apo të ulëta".** Kjo është shkelje e rëndë e të drejtave të fëmijëve dhe kjo nuk duhet të tolerohet në asnjë rrethanë nga MPMS dhe MSH.
- **Funksionalizimi i formave në spitale për regjistrimin e historikut të shtatëzanisë, është nevojë e menjëhershme.** Në spital shumë nga foshnjat potencial për braktisje mund të lindin me deformime të shtyllës kurrizore, apo probleme të tjera shëndetësore ku shkak mund të jetë sjelljet vetëmohuese që nëna shtatëzanë stimulon. Punëtorët social duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë e këtyre formave. KOMF poashtu rekomandon unifikimin e dokumentacionit në spital në mënyrë që të përmbushë interesin më të mirë të fëmijës njëkohësisht.
- **Të vendosen dhe mbikëqyren rregullat etike dhe profesionale për stafin që merret me fëmijë të braktisur,** me qëllim të shmangies nga rreziqet që mund t'i kanosen fëmijës në rast të mosrespektimit të konfidencialitetit.
- **Spitali duhet të marrë masa të menjëhershme sigurie.** Reparti i gjinekologjisë duhet të ketë kontroll rigoroz për prindërit që paraqiten. Asnjë nënë nuk duhet të largohet nga Spitali pa lënë shënimet dhe kontaktet e nevojshme për Qendrat për Punë Sociale.
- **Funksionalizimi i komunikimit ndërinstitucional, përmes marrëveshjeve të bëra ndërinstitucionale dhe formave zyrtare të referimit.** Mangësitë në komunikim ndërinstitucional (brenda përbrenda spitalit, spitalit me QPS-të, QPS-të me policinë, etj) krijon automatikisht shmangie të përgjegjësive.
- **Të rritet përgjegjësia e QPS-ve në mbrojtjen e fëmijëve të braktisur.** Stafi i QPS-së është një staf profesionist i cili ka në dorë të tashmen dhe të ardhmen e këtyre fëmijëve. Vizitat për fëmijët e vendosur në format alternative të strehimit nga ana e punëtorëve social janë të detyruara me ligj. Ligji detyron menaxherin e rastit së paku një herë në muaj të vizitojë fëmijën. Përdërisa obligon kujdestarin ligjor që të silltet dhe të veprojë si prind i mirë për fëmijën për aq kohë sa atij të i zgjidhet statusi dhe të adoptohet. QPS-të duhet të ndërmmarrin të gjitha veprimet e nevojshme në kohë dhe pa neglizhencë sipas legjisllacionit në fuqi dhe standardeve minimale të vendosura nga MPMS.
- **Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme QPS-të gjatë menaxhimit të rasteve të fëmijëve të braktisur, në mënyrë që fëmijët të largohen sa më shpejt nga institucionet rezidenciale, e të iu zgjidhet sa më shpejt statusi.** Bazuar në të dhënat nga terreni vërehet një tendencë e punëtorëve social për të i dërguar fëmijët në SOS Fshatrat e Fëmijëve, gjë që kërkon ndërhyrje të menjëhershme.
- **Të zgjidhet sa më parë çështja e testit të ADN-së.** Duke qenë se është e pamundur që të realizohen testet e ADN-së brenda territorit të Kosovës, realizmi i këtij testi ka kosto të lartë jashtë Kosovës. Sidomos duke marrë parasysh që disa nga lëndët e fëmijëve të braktisur janë zvarritur me vite të tëra në Gjykatë në mungesë të vërtetimit të atësisë, KOMF propozon dy alternativa:

1. Krijimi i një buxheti të caktuar nga Komunitat – DKSHMS-të në bazë të tregut të punës, i cili do të i vinte në ndihmë QPS-ve për rastet e vërtetësisë së atësisë/amësisë;
 2. Ndërtimit i një laboratorit nga MSH i cili do të kishte funksionin e realizimit të këtyre testeve.
- **Deklaratat e marra nga QPS duhet të shihen si pjesë e punës sociale**, për të punuar në mundësitë e ribashkimit dhe jo të perceptohen si deklarata të plotfuqishme që parashikojnë afatet kohore dhe vendimmarrëse.
 - **Të bëhet unifikimi i praktikave të punës mes gjykatësve dhe punëtorëve socialë lidhur me punën për fëmijët e braktisur.** Nga të gjitha palët e përfshira në këtë analizë reflektohet nevoja që të mbahen trajnime të përbashkëta me qëllim të krijimit të një praktike të unifikuar për punën me rastet e adoptimeve, madje për shkak të ndërveprimit dhe bashkëpunimit trajnimet duhet të mbahen bashkërisht mes Gjykatave dhe Qendrave për Punë Sociale.
 - **Paneli për vendosjen e fëmijëve në strehim familjar dhe adoptim në kuadër të MPMS, të takohet më shpesh me qëllim të shqyrtimit të lëndëve në kohë dhe shmangies së qëndrimit të gjatë të fëmijëve në spital apo në format alternative të strehimit.**
 - **Krijimi i Udhëzimit Administrativ nga MPMS për rregullimin e procedurave të adoptimit në QPS, me qëllim të qartësisë të procedurave për adoptimin e fëmijëve të braktisur të zhvilluara nga QPS-të si dhe përcaktimin e afateve kohore.** Bazuar në të dhënat nga terreni shumë procedura të zhvilluara nga QPS-të lidhur me adoptimin janë në mjegull, praktikat janë të ndryshme varësisht nga Komunitat, derisa ka abuzime me kohëzgjatjen për adoptim. KOMF rekomandon që QPS-të duhet të marrin përgjegjësi për afatet kohore. Ky Udhëzim Administrativ duhet të iu vijë në ndihmë QPS-ve dhe duhet të mirëpërcaktojë çdo procedurë dhe afat kohor në kronologji me interesin më të mirë të fëmijës. Zbatimi konform ligjit i këtij Udhëzimi Administrativ duhet të monitorohet nga MPMS për të siguruar cilësinë.
 - **Funksionalizimi i inspektimit të shërbimeve sociale dhe familjare nga MPMS drejt QPS-ve dhe OJQ-ve që ofrojnë shërbime për fëmijët e braktisur.** Megjithatë i paraparë në kuadër të Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare i ndryshuar Nr. 2011/04-L-081, inspektimi tani për tani ka munguar. Funksionalizimi i inspektimit është një domosdoshmëri të cilën e kërkojnë standardet bashkëkohore për rritjen e cilësisë së shërbimeve sociale dhe familjare për personat në nevojë sociale.
-

4.2 Rekomandime afatmesme

- **Hartimi i politikave, programeve dhe shërbimeve për parandalimin e braktisjes nga MPMS, MSH dhe Komunitet, me qëllim të ndërveprimit ndaj fenomenit të braktisjes.** Programet duhet të orientohen drejt të rinjve, gjeneratave të reja që janë prindërit e ardhshëm potencial. Bazuar në indikatorët e braktisjes, duhet të punohet në parandalim të shtatëzanive të paplanifikuara/padëshiruara. Politikat dhe programe duhet të aplikohen poashtu në spital dhe në QPS. Studimet e bëra në fushën e parandalimit të braktisjes së fëmijëve tregojnë rëndësinë e shërbimeve si një ndër pikat kyçe për reduktimin e rasteve të braktisjes.
- **Të krijohen kushte për mbështetje financiare dhe sociale nënave vetëushqyese në Kosovë.** Një ndër arsytet e braktisjes në Kosovë janë dhe kushtet ekonomike. Vajzat/gratë viktima të këtij fenomeni detyrohen të braktisin sepse shpesh nuk gjejnë mbështetje financiare.
- **Fuqizimi i Këshillimores ekzistuese në spital nga MSH, në repartin gjinekologjik, me qëllim që kjo Këshillimore të ketë një rol shtesë në të ardhmen në ofrimin e këshillave dhe mbështetjes së nënave potenciale dhe në rrezik të braktisjes së foshnjave të porsalindura.** Kjo qendër do të kishte efektin e saj progresiv si në parandalim ashtu dhe në përkujdesje. Nga një studim i bërë në Rumani²⁶, rezultatet kanë treguar se kur dy punëtorë social janë futur në klinikën e gjinekologjisë dhe kanë punuar intensivisht me nënat në këshillim për një periudhë gjashtë mujore, numri i braktisjes së fëmijëve ka rënë nga 64 braktisje në 16.
- **Zhvillimi i strehimit familjar në Kosovë nga Komunitet – QPS-të, si formë e mbrojtjes deri në zgjidhjen e statusit të fëmijës.** Rekrutimi i familjeve strehuese për nevoja të ndryshme të fëmijëve, ashtu që ato të jenë gjithmonë të gatshme të kujdesen edhe për fëmijët e porsalindur me aftësi të kufizuara, në mënyrë që të parandalohet qëndrimi i gjatë i fëmijëve në spital apo në strehim rezidencial. Rritja e vlerës bazë, kjo bazuar në shportën e konsumit dhe indeksin e inflacionit të çmimeve të konsumit është më se e nevojshme. Rekomandohet që familjet strehuese të realizojnë përfitime sociale apo shëndetësore në emër të të qenurit familje strehuese. Strehimi familjar vazhdon të mos përmbush nevojat e të gjitha komunave, duke bërë kështu që fëmijëve të braktisur në shumë raste t’iu mohohet e drejta për të njohur atmosferën familjare. Mungesa e një lidhje me një person bën që fëmijët të mos krijojnë ndjenjat bazë të personalitetit të tyre, siç janë siguria dhe besimi, pasojat çojnë deri në dëmtime neuropsikobiologjike të hemisferës së djathtë të trurit por edhe çrregullime psikike që mund të manifestohen në moshë adoleshence ose më vonë. Rikuperimet nga pasoja të tilla asnjëherë nuk arrijnë një nivel të plotë dhe gjithashtu kanë kosto të madhe për individin dhe gjithë shoqërinë.
- **Plotësim/ndryshimi i Ligjit të Familjes të Kosovës,** Organi i Kujdestarisë nuk duhet të jetë i përcaktuar në rolin e një organi këshillëdhënës tek procedura e adoptimit, mirëpo rekomandohet të përkufizohet si një organ kompetent fakultativ për të zhvilluar punën sociale rreth procesit të adoptimit. **Rekomandohet qartësimi i roli të Panelit për Vendosje dhe Adoptim (vënor dhe ndërkombëtar). Vënia e kriterëve/kërkesave rreth përcaktimit të interesit më të mirë të fëmijës** në rastin e vendosjes për secilën formë alternative të mbrojtjes duhet të përfshihet në kuadër të legjisllacionit.

²⁶ Browne, K. D. Chou, S. Poupard, P.Pop, V. & Vettor, S. (2006). *Zhvillimi i strategjive dhe veprimeve lidhur me parandalimin e braktisjes së foshnjave në Rumani Raporti i UNICEF; Qeverisa e Rumanisë. Bukuresht: Zyra e UNICEF në Rumani*

- **Ngritja e kapaciteteve të zyrtarëve të shërbimeve sociale dhe familjare dhe DKSHMS-ve**, përmes trajnimeve rreth legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e fëmijëve të braktisur, procedurat dhe afatet ligjore për aplikimin e formave të mbrojtjes, me fokus tek adoptimi.
- **Vetëdijesimi i opinionit ndaj fenomenit të diskriminimit të fëmijëve të braktisur që janë me aftësi të kufizuara**, për të mundësuar dhe për të kontribuar në zhvillimin sa më të shëndetshëm për të ardhmen e këtyre fëmijëve.
- **Shtimi i burimeve njerëzore me staf të profesionalizuar**. QPS-të shprehen se kanë nevojë për staf, sidomos të profilit të psikologut apo punëtorit social, këtë nevojë e shprehin edhe Gjykatat duke treguar se duhet të rritet numri i gjyqtarëve që merren me çështjet civile (përfshirë rastet e adoptimit të fëmijëve të braktisur). Gjithashtu në Spital mjekët e repartit të gjinekologjisë kërkojnë ndihmë për rritje të numrit të stafit për të punuar për fëmijët e porsalindur, ku kjo gjë do të mund të bëhej edhe me një riorganizim të burimeve njerëzore në kuadër të stafit aktual në QKUK.
- **Sigurimi i grantit për shërbime sociale sipas njërës nga dy alternativat që KOMF ka propozuar**. Për të siguruar mirëqenien dhe ofrimin e shërbimeve bashkëkohore rekomandohet plotësim ndryshimi i LFPL të orientohet sipas njërës nga dy alternativat e KOMF:
 1. **Alternativa I:** Grant specifik për shërbimet sociale i llojit të mbyllur, është alternativë më adekuate për ofrimin e një minimumi të sigurt të shërbimeve sociale.
 2. **Alternativa II:** Të bëhet ndarja e dedikuar për shërbime sociale në përqindje brenda grantit të përgjithshëm. KOMF bën me dije që alternativa e dytë nuk garanton siguri financiare në masë sikurse alternativa e parë.



KOMF:

16 organizata jo-qeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, me qëllim të koordinimit të mëtejshëm të përpjekjeve të tyre në mbrojtjen e fëmijëve, me mision mbrojtjen, respektimin dhe avancimin e mirëqenies dhe të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Organizatat anëtare: Associazione Amici dei Bambini, Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim - ASTRA, Iniciativa 6, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore MVPT, One to One Children's Fund, One To One Kosova - Qendra e Këshillimit për Familje, Organizata Rinore Akti, Save the Children, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë, Terre des hommes, World Vision, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, OPFAKKOS, Qendra për Arsim e Kosovës - KEC, Programi për të Drejtat Civile.



KOMF përbëhet nga:

16 organizata jo-qeveritare që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve në Kosovë, me qëllim të koordinimit të mëtejshëm të përpjekjeve të tyre në mbrojtjen e fëmijëve, me mision mbrojtjen, respektimin dhe avancimin e mirëqenies dhe të drejtave të fëmijëve në Kosovë.

Organizatat anëtare: Associazione Amici dei Bambini, Asociacioni për Trajnime Sociale, Hulumtime dhe Avokim - ASTRA, Iniciativa 6, Qendra për Mbrojtjen e Viktimave dhe Parandalimin e Trafikimit me qenie njerëzore MVPT, One to One Children's Fund, One To One Kosova - Qendra e Këshillimit për Familje, Organizata Rinore Akti, Save the Children, Shpresa dhe Shtëpi për Fëmijët Kosovë, Terre des hommes, World Vision, SOS Fshatrat e Fëmijëve Kosovë, OPFAKKOS, Qendra për Arsim e Kosovës - KEC, Programi për të Drejtat Civile.

